



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 4416 prot.

Pukë, më 13.03.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 3.datë 13.03.2026

“PËR MIRATIMIN E KRIJIMIT TË KËSHILLIT VENDOR PËR SIGURINË PUBLIKE NË
BASHKINË PUKË”

Këshilli Bashkiak Pukë, në mbledhjen e radhës të datës _____, 2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Pukë “Mbi miratimin e krijimit të Këshillit Vendor për Sigurinë Publike”, dhe në mbështetje të nenit 29 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar; VKM nr. 678, datë 30.10.2024 “Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendorë të sigurisë publike” dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e sigurisë publike;

VENDOSI:

- I. Miratimin e krijimit të Këshillit Vendor për Sigurinë Publike në Bashkinë Pukë.
- II. Këshilli Vendor për Sigurinë Publike përbëhet nga:
 1. Kryetari i Bashkisë Pukë
 2. Shefi i Komisarariatit të Policisë Pukë;
 3. Shefi i Policisë Bashkiake;
 4. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve dhe Emergjencave Civile në Bashki;
 5. Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar;
 6. Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;
 7. Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor,
 8. Përfaqësues i Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor;
 9. Përfaqësues i Agjencisë Rajonale të Mjedisit;
 10. Përfaqësues i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (Drejtoria Rajonale);
 11. Përfaqësues i administratës rajonale të zonave të mbrojtura,
 12. Koordinator vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marredhëniet familjare,
 13. Përfaqësues i njesisë për mbrojtjen e fëmijëve,
 14. Kryeinspektori i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit,
 15. Përfaqësuesi i Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Paraqitën projektin;

Drejtori i Menaxhimit të BNJ.


Sokol Gjoni

Juristi

Aida Sinani

Kryetari

Rrok Dodaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2946/prot.

Pukë, më 13.03.2026

RELACION
PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR MIRATIMIN E KRIJIMIT TË KËSHILLIT
VENDOR PËR SIGURINË PUBLIKE NË BASHKINË PUKË”

Në mbështetje të nenit 29 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe të VKM nr. 678, datë 30.10.2024 “Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendorë të sigurisë publike”, paraqitet për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit Bashkiak Pukë projektvendimi “Për miratimin e krijimit të Këshillit Vendor për Sigurinë Publike në Bashkinë Pukë”.

Siguria publike përbën një nga elementët themelorë për funksionimin normal të jetës shoqërore dhe për garantimin e një mjedisi të sigurt për qytetarët. Në këtë kuadër, legjislacioni në fuqi parashikon krijimin e mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel vendor, me qëllim koordinimin e veprimeve ndërmjet institucioneve që kanë përgjegjësi në fushën e rendit dhe sigurisë publike.

Krijimi i **Këshillit Vendor për Sigurinë Publike** synon të forcojë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet Bashkisë Pukë, Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera publike që operojnë në territorin e bashkisë, për trajtimin dhe adresimin në mënyrë të koordinuar të problematikave që lidhen me sigurinë publike, parandalimin e kriminalitetit, menaxhimin e emergjencave civile, mbrojtjen e fëmijëve, luftën kundër dhunës në familje, si dhe çështje të tjera që ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë dhe mirëqenien e komunitetit.

Nëpërmjet këtij mekanizmi institucional synohet:

- rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional në nivel vendor;
- identifikimi dhe analizimi i problematikave që lidhen me sigurinë publike në territorin e Bashkisë Pukë;
- hartimi i rekomandimeve dhe masave konkrete për përmirësimin e situatës së sigurisë;
- rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për çështje që lidhen me sigurinë publike dhe rendin shoqëror.


Në përputhje me VKM nr. 678, datë 30.10.2024, në projektvendim është përcaktuar edhe përbërja e Këshillit Vendor për Sigurinë Publike, e cila përfshin përfaqësues të institucioneve kryesore që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Bashkisë Pukë dhe që kanë rol të drejtpërdrejtë në garantimin e sigurisë publike dhe mbrojtjen e interesit të komunitetit.

Krijimi i këtij këshilli do të mundësojë një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse në trajtimin e çështjeve të sigurisë publike, duke rritur efektivitetin e veprimeve parandaluese dhe duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Për sa më sipër, propozohet që **Këshilli Bashkiak Pukë** të shqyrtojë dhe të miratojë projektvendimin “Për miratimin e krijimit të Këshillit Vendor për Sigurinë Publike në Bashkinë Pukë”.

DREJTORI I DREJTORISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

SOKOL GJONI

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Sokol Gjoni', is written over the printed name. The signature is stylized, with a large circular loop at the beginning and a long horizontal stroke extending to the right.